



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2019:207096

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05439077

P.nr.415/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN – DEGA NË VITI, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Naser Maliqi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Shqipe Kastrati, në çështjen penale ndaj të akuzuarit V.S, nga Gjilani, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me 1 të KPRK, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me numër PP.II.nr.1403/2019 të datës 18.09.2019 pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në të cilin kanë prezantuar prokurorja e shtetit Huma Jetishi, përfaqësuesi i të dëmtuarës KEDS-D.R, dhe i pandehuri i lartcekur, me datë 07.03.2023 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 12.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari V.S, nga babai I dhe nëna S, e lindur H, i lindur me datënë fshatinku edhe jeton, i martuar, baba i gjashtë fëmijëve, ka të kryer shkollën e lartë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal identifikues

ËSHTË FAJTOR

Sepse prej datës së pa pavërtetuar deri me datën 19.02.2019, në shtëpinë e tij në fshatin....., Komuna e Vitisë, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasurorë ka vjedhë shërbime të rrymës elektrike në atë mënyrë që i njëjti është lidhë direkt në rrjet elektrik jashtë pikës matëse në kabllin furnizues dhe në këtë mënyrë ka shpenzuar energji elektrike në mënyrë të pa autorizuar e cila rrymë fare nuk është regjistruar në njehsorin elektrike duke e dëmtuar KEDS-in Distribuimi në Gjilan, në shumë prej 304.75 euro

-Me çka ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK,

Andaj gjykata në bazë të neneve 4, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 70, 71 dhe 72 të KPRK-ës dhe nenit 358, 359, 360, 361 dhe 364 të KPP-ës, të akuzuarin e lartcekur:

E GJYKON

Me dënim me gjobë në shumën prej 300 € (treqindeuro) i cili dënim nuk do të ekzekutohet me kusht nëse i akuzuari në afat prej 1 (një) viti nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë, nuk kryen vepër tjetër penale.

Obligohet i akuzuari që në emër të kërkesës pasurore juridike të dëmtuarës KEDS t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar me vepër penale në shumën prej 304.75 €, në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Obligohet i akuzuari i lartcekur që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 20 € (njëzet euro) si dhe shumën prej 20 € (njëzet euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

ARSYETIM

1.Rrjedha e çështjes dhe fjalët përfundimtare të palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me datë 18.09.2019 ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.1403/2019 kundër të akuzuarit V.S, nga Gjilani, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me 1 të KPRK.

Me krijimin e kushteve ligjore gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor ku është bërë administrimi i provave personale dhe materiale si dhe palët kanë dhënë fjalët e tyre përfundimtare.

Prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e shtjelluara dhe të përshkruara e sidomos duke u bazuar në deklaratat e dëshmitarëve zyrtar të KEDS-it A.L dhe Xh.M, të cilët në këtë seancë kanë deklaruar se kanë qenë në vendin e ngjarjes me datë 19.02.2019 në fshatinnë shtëpinë e të pandehurit dhe aty kanë vërejtur se i pandehuri ka pasur një lidhje direkte përmes një kabllos nga tavani i shtëpisë ku edhe kanë përpilua procesverbal andaj nga të gjitha të lartcekurat prokurorja ka kërkuar nga gjykata që të njëjtin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj me dënim të paraparë sipas ligjit.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës KEDS-D.R, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështesin në tërësi fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit, gjithashtu i bashkangjitet ndjekjes penale dhe parashtron kërkesë pasurore juridike në shumën prej 304.75 euro.

I akuzuari V.S, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se ka dëshirë që të lirohet, duke theksuar se nuk e ka vjedhur rrymën dhe se nuk është shtëpia e tij.

2.Provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor

Gjykata pas administrimit të provave personale dhe materiale plotësisht ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit dhe atë në bazë të:

- Dëgjimit të dëshmitarit Xh.M
 - Dëgjimi të dëshmitarit A.L
 - Leximit të provave materiale dhe atë: procesverbalit me numër 2497395 i datës 19.02.20219, transaksionet e datës 20.02.2019, fatura e shfrytëzimit të rrymës me numër DGLHP.... e datës 20.02.2019, kalkulimi RH fatura nga sektori i rikthimit të humbjeve me numër 230971 e datës 20.02.2019, foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes, dhe
- Mbrojtjen e të akuzuarit

2.1. Deklarata e dëshmitarit Xh.M

Dëshmitari Xh.M në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se e me datën 19.02.2024 së bashku me kolegët e tij A.L, I.T dhe V.H kemi qenë në fshatin te shtëpia e tani të akuzuarit V.S, arsyeja e shkuarjes kishte qenë kontrolla se diçka nuk është në rregull në harxhimin e energjisë elektrike. Gjatë kontrollimit kemi konstatuar se njehsori elektrik ka qenë i regjistruar në emër të R.It dhe pas ndërprerjes së energjisë elektrike konsumatori ka pasë edhe një lidhje tjetër jashtë rrjetit elektrike ku është shfrytëzuar në mënyrë të pa autorizuar. Në shtëpinë e tij ku ka qenë duke banuar e ka shfrytëzuar këtë rrymë për nevoja të veta, e cila rrymë nuk është matë dhe përmes njehsorit elektrik, kabloja ka qenë e lidhur kah tavani, gjatë kontrollit ka qenë prezent djali i J, dhe paraprakisht kush banon dhe shënimet tjera na i kanë dhënë se aty banon V.S, i cili është shfrytëzues i rrymës. Poashtu dëshmitari ka deklaruar se nuk e kam parë duke vjedhur rrymë por e kam gjetur kabllën jashtë njehsorit.

2.2. Deklarata e dëshmitarit A.L

Dëshmitari A.L, në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se në vendin e ngjarjes tek shtëpia e të pandehurit në fshatin B, kemi qenë unë dhe Xh.M, V.H dhe I.T, për kontroll të energjisë elektrike te shtëpia e tani të pandehurit. Prezent ka qenë Jetmiri një djalë i ri. Kemi konstatuar së bashku me kolegët se i pandehuri ka një kablo elektrike në lidhje direkte prej tavanit e jashtë pikës matëse, ne aty kemi përpiluar procesverbal mirëpo nuk na e ka nënshkruar ai djali që ka qenë prezent. Ne e kemi konstatuar që lidhja është direkt për shkak se e kemi nalë rrymën te ora dhe përsëri rrymë ka pasur në shtëpi. Energjia elektrike e harxhuar nuk është matë në njehsor elektrik, e kemi kontrolluar edhe njehsorin elektrik por nuk ka pasur bllombë distributive për me shpërnda, në oborr kanë qenë dy shpija, një e vjetër që ka pasë orë që lidhja ka qenë jashtë njehsorit dhe shtëpia e re që është furnizu nga shtëpia e vjetër.

2.3.Mbrojtja e të akuzuarit V.S

I akuzuari V.S, në mbrojtjen e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në

Gjilan, poashtu ka deklaruar se unë furnizohem me rrymë elektrike nga vëllau R.S, i cili punon në KEK, nga shtëpia e tij, ndërsa në shtëpinë time nuk kam pasur njehsor, nuk është e vërtetë që ka pasur kablllo të lidhur në mënyrë elektrike sepse dëshmitarët nuk kanë thënë të vërtetën, dëshmitarët unë nuk i njohë dhe nuk e dijë pse kanë dhënë këto deklaratata.

3. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Në seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale, gjykata komfor nenit 7 dhe 360 të KPP-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë, vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe ato në favor të tij duke i mundur të akuzuarit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerr përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara, me ç' rast pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat janë administruar në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ka ardhur në përfundim se deklaratës së dëshmitarëve Xh.M dhe A.L, duhet t'iu falet besimi, te cilet ne menyre identike kan deklaruar se ditën kritike kan qen ne shtëpinë e te akuzuarit, kan konstatuar se i njëjti e ka te lidhur një kabull jashtë njësorit për matjen e energjisë elektrike, ashtu qe energjia e hargjuar nuk eshte regjistruar, ngase të njëjtat janë në harmoni edhe me provat e tjera materiale të cilat janë administruar nga ana e gjykatës ngase dëshmitarët faktet i kanë treguar në mënyrë të njëjtë, gjë kjo e cila edhe ua ka ngrit vlerën e besueshmërisë së këtyre deklaratave të tyre, ndërsa mbrojtjes së të akuzuarit V.S, nuk i është fale besimi lidhur me faktin se i njëjti nuk e ka kryer veprën penale, sepse e njëjta nuk është në harmoni me provat tjera personale dhe materiale të administruara nga ana e gjykatës, e të cilat tregojnë një gjendje faktike tjetër për të cilën i njëjti ka pretenduar.

Në këtë çështje penalo juridike pas vlerësimit dhe analizimit të provave personale dhe materiale gjykata gjeti se nuk ishte kontestuese fakti se prej datës së pavërtetuar e deri më datën 19.02.2019 në fshatin, Komuna e Vitisë në shtëpinë e të akuzuarit V.S, në mënyrë të pa autorizuar është shfrytëzuar energji elektrike, këto fakte vërtetohen njëkohësisht edhe me provat materiale procesverbali me numër 2497395 i datës 19.02.20219, tranksacionet e datës 20.02.2019, fatura e shfrytëzimit të rrymës me numër DGLHP.... e datës 20.02.2019, kalkulimi RH fatura nga sektori i rikthimit të humbjeve me numër 230971 e datës 20.02.2019, foto dokumentacioni nga vendi i ngjarjes, mirëpo gjykata gjeti se nuk është kontestuese në këtë çështje penalo juridike fakti nëse i akuzuari kishte bërë lidhje direkte në rrjetin elektrik jashtë pikës matëse në kabllon furnizues dhe në këtë mënyrë kishte bërë harxhimin e pa autorizuar të energjisë elektrike me çka kishte pamundur regjistrimin e shpenzuar të energjisë elektrike, ashtu siq përshkruhet në dispozitivin e aktgjykimit.

Gjykata faktin kontestues e zgjodhi duke u bazuar në deklaratën e dëshmitarit Xh.M, i cili në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se gjatë kontrollimit tek shtëpia e të akuzuarit V.S kemi konstatuar se njehsori elektrik ka qenë i regjistruar në emër të R.I dhe pas ndërprerjes së energjisë elektrike konsumatori ka pasë edhe një lidhje tjetër jashtë rrjetit elektrike ku është shfrytëzuar në mënyrë të pa autorizuar. Në shtëpinë e tij ku ka qenë duke banuar e ka

shfrytëzuar këtë rrymë për nevoja të veta, e cila rrymë nuk është matë dhe përmes njehsorit elektrik, kabloja ka qenë e lidhur kah tavani, gjatë kontrollit ka qenë prezent djali i J, dhe paraprakisht kush banon dhe shënimet tjera na i kanë dhënë se aty banon V.S, i cili është shfrytëzues i rrymës. Poashtu këtë fakt kontestues gjykata e zgjodhi duke u bazuar edhe në deklaratën e dëshmitarit A.L i cili në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: në vendin e ngjarjes tek shtëpia e të pandehurit në fshatin B, kemi qenë së bashku me kolegët Xh.M, V.H dhe I.T, për kontroll të energjisë elektrike të shtëpia e tani të pandehurit. Prezent ka qenë Jetmiri një djalë i ri. Kemi konstatuar së bashku me kolegët se i pandehuri ka një kablo elektrike në lidhje direkte prej tavanit e jashtë pikës matëse, në aty kemi përpiluar procesverbal mirëpo nuk na e ka nënshkruar ai djali që ka qenë prezent. Ne e kemi konstatuar që lidhja është direkt për shkak se e kemi nalë rrymën të ora dhe përsëri rrymë ka pasur në shtëpi. Energjia elektrike e harxhuar nuk është matë në njehsor elektrik, e kemi kontrolluar edhe njehsorin elektrik por nuk ka pasur bllobë distributive për me shpërnda, në oborr kanë qenë dy shpija, një e vjetër që ka pasë orë që lidhja ka qenë jashtë njehsorit dhe shtëpia e re që është furnizu nga shtëpia e vjetër.

Poashtu ky fakt vërtetohet pjesërisht edhe nga mbrojtja e vet të akuzuarit V.S, i cili në raport me këtë fakt ka deklaruar se: unë furnizohem me rrymë elektrike nga vëllau R.S, i cili punon në KEK, nga shtëpia e tij, ndërsa në shtëpinë time nuk kam pasur njehsor. Ndërsa sa i përket mbrojtjes së të akuzuarit sidomos në raport me veprimet e tij inkriminuese i cili ka deklaruar se nuk është e vërtetë që ka pasur kablo të lidhur në mënyrë direkte gjykata një mbrojtje të tillë nuk mundi ta pranoj, ngase e njëjta është në kundërshtim me deklaratat e dëshmitarëve e po ashtu edhe me provat materiale të administruara nga ana e gjykatës, ndërsa pjesa tjetër e mbrojtjes së të akuzuarit në raport me ngjarjen ishte e besueshme sepse të njëjtit ngjarjen e tregojnë njëjtë, por i akuzuari i mohon veprimet inkriminuese me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale.

4.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat gjykata erdhi në përfundim se është vërtetuar plotësisht gjendja faktike si dhe është vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar mirë se i akuzuari V.S, e ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve, nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

5.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar, që të akuzuarit duhet ti shqiptohen dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesve si dhe përgjegjësinë penale të tij, ashtu që me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës ku mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit e cila nga provat materiale të administruara në seancat e shqyrtimit gjyqësor del të jetë e lartë, meqenëse i akuzuarit me rastin e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm për veprimet e tija dhe

veprën penale e ka kryer me dashje dhe atë direkte, po ashtu me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, sjelljen e mëparshme të kryesit, rrethanat personale të tij si dhe sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata është bazuar edhe në rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës ashtu që si rrethana lehtësuese për të akuzuarin mori rrethanat personale të tij për faktin se për të njëjtin ishte hera e parë që bie ndesh me ligjin përkatësisht më parë nuk ka qenë i gjykuar e as dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë për çfarëdo vepre penale, ndërsa si rrethana rënduese për të akuzuarin gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e të akuzuarit sepse nga përshkrimi faktik si dhe provat të administruara del se i akuzuari veprën penale e ka kryer me dashje dhe atë direkte duke ditur se me veprimet e tija do të shkaktohet pasoja e ndaluar dhe përkundër kësaj ai e ka dëshiruar përkatësisht ka ndërmarrë veprime për shkaktimin e saj ashtu siç përshkruhet në dispozitivin e këtij aktgjykimi, gjithashtu si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjykata mori edhe këmbëngulësinë e shfaqur nga ana e tij për kryerjen e veprës penale sepse siç shihet nga përshkrimi faktik por edhe nga provat e administruara del se i njëjti ka qenë i vendosur për ta kryer këtë vepër penale andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata të akuzuarit i shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të tij mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

6. Vendimi lidhur me kërkesën pasurore juridike.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike i akuzuari është obliguar që në emër të kërkesës pasurore juridike të dëmtuarës KEDS t'ia kompensoj dëmin e shkaktuar me vepër penale në shumën prej 304.75 €, në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

7.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjykata duke u bazuar në nenin 450 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të akuzuarin ta obligojë që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 20 € (njëzet euro) si dhe shumën prej 20 € (njëzet euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA VITI

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.415/2019 me datë 12.03.2024

Bashkëpunëtorja profesionale
Shqipe Kastrati

Gjyqtari i vetëm gjykues
Naser Maliqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.